



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 22-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 27. 02. 2020, në sallën e vogël për mbledhje me fillim në ora 13⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Hyra Bytyçi, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani
4. Albulena Kelmendi, anëtare
5. Ukë Kryeziu, anëtar
6. Afrim Miftari, anëtar
7. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
2. Visar Kozhani, zyrtar financiar
3. Elmi Bublica, menaxher i KRU "Prishtina".
4. Kimete Jashanica, OSBE

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të e KPF-së.
2. Informatë nga KUR "Prishtina"-NjOU-Lipjan, mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të Komunës së Lipjanit.
3. Raporti i shpenzimeve Janar-Dhjetor 2029.
4. Propozim vendim për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2019.
5. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020.
6. Propozim vendim për parcelën kadastrale P-71409044-01745-0

Albulena Kelmendi në seancën e fundit të Kuvendit kam kërkuar që të ketë një informatë nga DKA-ja për braktisjen e shkollave nga nxënësit.

Daut Azemi, për shkak që po bëhen pika shumë nuk e kemi sjellë atë informatë por do ta sjellim në seancat e ardhshme.

Pastaj kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat për aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 21-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Daut Azemi, kryesues i Kuvendit tha se pasi që e kemi prezent drejtorin e KRU "Prishtina", Elmi Biblica, ne si KPF, a po vazhdojmë me informatat apo po i kalojmë direkt në Kuvend.

Lumturije Bytyqi-Hasani, unë propozoj që kjo pikë të shkon në Kuvend.

Ukë Kryeziu, është mirë që këto informata mos të përfshihen hiq në KPF por të shkojnë direkt në Kuvend.

Daut Azemi, propozoj që pika e dytë dhe e tretë të kalojnë në Kuvend.

Pastaj u kalua në pikën e katër të rendit të ditës

IV

Propozim vendim për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2019

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Visar Kozhanit, zyrtar i lartë financiar, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ukë Kryeziu, më gëzon fakti që ka rritje të të hyrave, kam një pyetje për projektet të cilat kanë mbetur në gjysmë siç është rruga Sllovi-Dobratin kur do të përfundohen. Po ashtu te shkollat për cilat shkolla bëhet fjalë?

Lumturije Bytyqi-Hasani, edhe unë i gëzohem rritjes së të hyrave, kam pyetje trotuari dhe parkingu në QKMF në Lipjan a do të përfshihet pasi që këtë pyetje e kam bërë edhe në Kuvend por nuk kam marrë përgjigje? Po ashtu renovimi i objektit të AMF-së në Babush është mirë që po renovohet por se di sa do të kryej punë.

Afrim Miftari, është inkurajim rritja e këtyre të hyrave, kam një pyetje te arsimit fillor a është fjala për oborret e shkollave.

Fehmi Rexhepi, kam një shqetësim të banorëve të fshatit Hallaq i Vogël ku rruga te varrezat është në gjendje të mjerushme a do të ketë mundësi të pakten të zhavorohet? Po

ashtu në fshatin Baincë është një kru që ka ujë shërues a ka mundësi që aty të intervenohet pasi që nuk ka rrugë?

Visar Kozhani, rruga Sllovi-Dobratin është në kontest gjygjësorë, ndërsa trotuari në QKMF, do të parashihet ose në ridestinim të mjeteve ose në rishiqim.

Daut Azemi, sa i përket çështjes së varrezave është caktuar një komision i cili është duke i verifikuar të gjitha varrezat në komunën e Lipjanit e të cilat do të përfshihen në buxhet rrugët e tyre.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimt dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Visar Kozhanit, zyrtar i lartë financiar, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, renovimi i banjove nëpër shkolla është një hap shumë i mirë pasi që në shumë shkolla banjot lën për të dëshiruar. Po ashtu po më pëlqen ideja e pjerrinave dhe do të ishte mirë që të gjitha shkollat e komunës së Lipjanit të vendosen këto pjerrina.

Ukë Kryeziu, edhe unë i mbështes këto por te ambulanca në Sllovi edhe pse është kjo pjerrina por është shumë e vështirë të kaloi një person pa ndihmën e dikujt.

Daut Azemi, ne së bashku me kryetarin kemi pasur një takim me personat me aftësi të kufizuar e të cilët më së miri i dijnë se ku kanë pengesa në rrugë. Po ashtu kryetari do ta caktoj një komision ku do të dal në teren dhe të shikoj këto pjerrinat se a i plotësojnë kushtet dhe nevojat e personave me nevoja të veçanta.

Afrim Miftari, a ka mundësi me na dhënë pak më shumë sqarime te tabela nr. 14 projekti i ri që përfshihet stadiumi në Dobrajë të Madhe etj.

Fehmi Rexhepi, një projekt për Medvec që është me VoJC RAE-në pse nuk po e shoh.

Visr Kozhani, ai projekt në Medvec ka qenë me donatorë dhe nuk përfshihet këtu.

Te tabela nr. 14 është projekti i ri pasi që punë kryesit e mëhershëm nuk e kanë kryer mirë dhe ju ka shkëputur kontratat.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimt dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim vendim për parcelën kadastrale P-71409044-01745-0

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Emina Rexhiqit, drejtoreshë e DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, kemi tri propozime, unë personalisht jam kundër propozimit të tretë për te tregu. Për mua do të ishte më e arsyeshme propozimi i parë ose i dytë.

Albulena Kelmendi, është një temë e dhimbshme por unë personalisht dhënien e tregut e kundërshtoj. Propozimi i parë po më duket më i arsyeshëm.

Ukë Kryeziu, është një pikë e rëndësishme është dashtë me u ndjekë të gjitha procedurat dhe ne duhet të ju përgjigjemi qytetarëve është mirë që ne me qenë unik dhe

me vendos aty e cila është më e mira. Unë për veti sikurse parafolësit e kundërshtoj dhënien e tregut por si propozim për dhënien e mjeteve po me duket më i arsyeshëm.

Hyra Bytyqi, edhe unë sikurse parafolësit e kundërshtoj dhënjën e tregut dhe mendoj që nga ana e ministrisë nuk ka ardhur një vlerësim i drejtë sa i përket këtyre pronave.

Afrim Miftari, ne duhet të marrim një vendim por cilindo vendim që e marrim është i ndijshëm.

Daut Azemi, është propozimi më i vështirë që e kemi pasur ndonjëherë nëse i bëhet pagesa është një shumë që vlerësimi nuk është bërë i drejtë nga ministria dhe është një shumë e madhe.

Sa i përket tregut unë personalisht do të votoj kundër.

Emina Rexhiq, me hartat zonale është duke u bërë një punë e madhe dhe nëse i jepet pjesa te sheshi që të ndërtohet duhet të respektohen kushtet dhe kriteret sipas drejtoratit tonë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimt dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Daut Azemi